



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 17, Datë 07.11.2011

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila jani | Kryetare |
| - Z. Gerdjan Xhanari | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtare |
| - Z. Zamir Stefani | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 07.11.2011, shqyrtoi përgjigjen e operatorit CEZ Shpërndarje, me shkresën nr. prot. 5598, date 21.09.2011, ndaj kërkesës për informacion te Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatoreve, drejtuar këtij operatori me shkresën nr. prot 25/1, date 10.08.2011, ne lidhje me fillimin e shqyrtimit te një numri te konsiderueshëm te ankesave te konsumatoreve ndaj operatorit CEZ Shpërndarje.

Komisioni pas shqyrtimit të shkresës se sipërpërmendur,

VËREN SE:

Në mbledhjen e tij te datës 14 gusht 2011, Komisioni filloi shqyrtimin e një numri te konsiderueshëm ankesash nga konsumatorët, kundrejt kompanisë CEZ Shpërndarje, për çështje te tilla si: mungesa e furnizimit me energji elektrike për një periudhe te gjate; mosdorëzimi i faturave te energjisë ne vendbanimet e konsumatoreve; mosinformimi ne kohe i konsumatoreve ne lidhje me ndryshimin e vendndodhjes se sporteleve; gjobitjen e konsumatoreve për shkak te mungesës se vulave ne aparatën matës; vendosjen e zërit “vlere e debisë” ne faturat e energjisë.

Këto çështje përbëjnë objekt te Ligjit nr. 9902, date 17.04.2010 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar nga Ligji nr. 10444, date 14.07.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatoreve””. Neni 2 (fusha e zbatimit), i këtij ligji parashikon se: “Ky ligj përfshin të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, që kanë të bëjnë me mallrat e konsumatorëve apo shërbime. Dispozitat e këtij ligji nuk do te zbatohen, kur ne dispozitat e tjera ligjore për

fushat përkatëse jepen trajtime me te favorshme për mbrojtjen e te drejtave te konsumatorëve”. Ne kuptim te këtij ligji, pika 14 e nenit 3, e konsideron operatorin CEZ Shpërndarje “tregtar”, pasi vepron për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike, tregtinë, biznesin, etj.

Ne këtë mbledhje, Komisioni vendosi që për një procedim të mëtejshëm të çështjes, të drejtohej operatorit CEZ Shpërndarje, me një kërkesë për informacion të detajuar, të argumentuar dhe të verifikueshëm, me evidencat përkatëse, për të gjithë problematiken e sipërpërmendur, dhe për vënien në dispozicion të listave të plota për një periudhë 1 vjeçare, të të gjithë abonentëve, që kanë pasur ndërprerje të furnizimit me energji elektrike; të konsumatoreve të gjobitur; të konsumatoreve që janë faturuar aforfe (1000 kwore/muaj); të konsumatoreve të faturuar me zërin “vlera e debisë”.

Komisioni, në mbledhjen e datës 07.11.2011, konstatoi se informacioni që përmban shkresa nr. 5598, date 21.09.2011, e operatorit CEZ Shpërndarje, nuk i ka dhënë përgjigje kërkesave të parashtruara në shkresën nr. prot 25/1, date 10.08.2011 të KMK, pasi ky informacion nuk është i detajuar, i argumentuar dhe i verifikueshëm, si dhe nuk është i plotësuar me evidencat përkatëse dhe me listat e kërkuara.

Gjithashtu, në shkresën e tij, operatori CEZ Shpërndarje ka refuzuar të japë informacion të detajuar tek Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatoreve, duke u shprehur se “...*ERE paraqitet si një hallke kompetente për shqyrtimin e ankesave të konsumatoreve tarifore. Në këtë kuptim, të gjitha të dhënat, informacionet, raportimet, që kanë të bëjnë me ankesat e konsumatoreve (përveç atyre të verifikimit të matësve, kompetence që i atribuohet DPM-se tashme) i dërgohen Entit Rregullator*”. Ndonëse, në Ligjin Nr. 9072, datë 23.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohen dispozita për rolin e ERE-s në lidhje me mbrojtjen e interesave të konsumatoreve, Ligji nr. 9902, i ndryshuar, parashikon në nenin 2 të sipërcituar, që zbatohen dispozitat ligjore që japin trajtimet me të favorshme për mbrojtjen e konsumatoreve, dhe në këtë kuptim, nenet 40 e 41 të Kreut I, Pjesa VII, të Ligjit 9902, parashikojnë dispozita të veçanta në lidhje me shitjen e energjisë, shërbimeve të ujit dhe telekomunikacionit.

Për sa me sipër, Komisioni e gjen informacionin të mangët dhe jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 52/1 të Ligjit nr. 9902, i ndryshuar, sipas të cilit “*Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë dhe jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji*”, duke sjelle si pasojë pengesë në procedurat e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesave të konsumatoreve.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në nenin 52, pika 4, nenin 52/1 dhe nenin 57 pikën 2/(d) të Ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatoreve”, si dhe në pikën 6 (c), të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008.

VENDOSI:

1. CEZ Shpërndarje, te gjobitet me shumën 300.000 leke.
2. CEZ Shpërndarje, te njoftoje menjëherë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatoreve për pagesën e gjobës brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi.

KRYETAR I KOMISIONIT

ANILA JANI

